



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.04.2022

MBLEDHJA Nr. 19,
Datë 28.04.2022, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 28.04.2022, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 19 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 20.04.2022
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes palëve, shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k.
3. Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 39, datë 10.03.2022 “Mbi kërkesën e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.02.2022, “Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë” me kapacitet të instaluar 12667 kW dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total të instaluar 14962 kW”
4. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
5. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., me nr. 372, seria F12/17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.07.2012, i ndryshuar
6. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Tamara Hydro Energy” sh.p.k. për licencim, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “Power Comm” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 466, seria T20, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 92, datë 02.06.2020

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI

Në Mungesë dhe me Autotizim
Anëtar i Bordit Maksim SHULI